



LISTA KONTROLLUESE E PUNËDHËNËSIT PËR VETËVLERËSIM

PJESA 1:	RREZIQET NË PUNË
Tema 2.5.	AGJENTËT BIOLOGJIKË
Nën-tema 2.5.1.	AGJENTËT BIOLOGJIKË
Ligji / rregulloret përkatëse:	• Rregullore (MPMS) Nr.05/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga risqet që lidhen me agjentët biologjikë në punë; • Rregullore (MPMS) Nr.04/2016 për kërkesat minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë dhe shëndetit në punë.
Shkurtesa:	• PPM – Pajisje Personale Mbrojtëse • RVAKK – Regjistrimi, Vlerësimi, Autorizimi dhe Kufizimi i Kimikateve • DDHS – Dokumentet e të Dhënave të Sigurisë • MPMS – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Përdorimi i listës kontrolluese:	Nëse përgjigjeni “Po” në një pyetje, ju lutemi kaloni në pyetjen tjetër, në rast se përgjigjeni “Jo” bëni vërejtje që mund të planifikoni të ndërmerren veprime për të përmbushur kërkesat ligjore.

Nr.	Pika kontrolli	Po	Jo	Vërejtje për zbatimin
	PARA VIZITËS NË LOKACION / VENDET E PUNES			
	* Përgatituni për vizitën në lokacion. Nëse nuk i mbani mend kërkesat tuaja të brendshme, udhëzimet për punën me agjentët biologjikë, lexojini përsëri dokumentet për të qenë gati për vizitën në lokacion. * Përgatitni një listë të plotë të të punësuarve në rast nëse punojnë me agjentët biologjikë të grupit 3 dhe/ose grupit 4.			
	INSPEKTIMI I LOKACIONIT / VENDEVE TË PUNËS			
	* Gjatë vizitës në lokacion / vendin e punës kushtojini vëmendje aktiviteteve që ndodhin. Nëse njerëz ose kafshë të gjalla ose të vdekura, ushqime, bimë dhe drunj, dhera ose ujëra janë të pranishëm në mjedisin e punës, duhet të vlerësohen risqet biologjike. * Aktivitetet përkatëse përfshijnë bujqësinë, industrinë ushqimore, kujdesin shëndetësor dhe shërbimet sociale, shërbimet veterinare, menaxhimin e mbeturinave dhe ujërave të zeza dhe shërbimet e funeraleve.			

	* Vëzhgoni procesin e asgjësimit të mbeturinave dhe sigurohuni që ndiqen procedurat standarde të operimit, përfshirë përdorimin e enëve të vulosura dhe të etiketuara qartë dhe dukshëm. * Kontrolloni nëse të punësuarit: ▪ përdorin PPM të përshtatshme ▪ nuk pinë, hanë, apo pinë duhan në zonat e punës ▪ janë pajisur me veshje mbrojtëse të përshtatshme ose veshje të tjera speciale të përshtatshme ▪ janë pajisur me vende ruajtje të ndara për veshjet e punës ose mbrojtëse dhe veshjet normale ▪ janë aftësuar për procedurat emergjente * Jepni shembullin tuaj, përdorni PPM-të në varësi të agjentëve biologjikë dhe rreziqeve që ekzistojnë në lokacion / vendet e punës! * Mbani shënime për vendet e vëzhguara të punës dhe bëni fotografi. Kushtojini vëmendje shembujve të mirë dhe jo të mirë. * Bisedoni me të punësuarit, tregohuni miqësorë, shpjegoni dhe këshillojini ata për rregullat e përgjithshme të sigurisë në punë me agjentë biologjikë. * Përfundoni inspektimin duke ofruar një rekomandim përfundimtar për sigurinë dhe fushat e mundshme për përmirësim.			
1.	A ekziston rreziku i agjentëve biologjikë në vendin e punës për shkak të natyrës së punës? Rregullore (MPMS) Nr.05/2017, Neni 5 * Nëse të punësuarit punojnë ose kanë kontakte të drejtpërdrejta me njerëz ose lëngje të trupit njerëzor, kafshë ose lëngje të trupit të kafshëve, produkte ushqimore, dhera, ujëra të zeza dhe mbeturina në përgjithësi, ata mund të jenë në rrezik ndaj agjentëve biologjikë.			
2.	Kontrolloni nëse programet e trajnimit dhe informacionit janë efektive për të punësuarit e ekspozuar ose potencialisht të ekspozuar ndaj gjakut dhe/ose lëngjeve të trupore, lëngjeve të trupit të kafshëve dhe/ose kafshëve, baktereve dhe organizmave të ngjashëm, kërpudhave. Rregullore (MPMS) Nr.05/2017, Neni 10			

	<i>* Pyetni çdo të punësuar a e dinë se sa shpesh duhet të lahen duart, a mund të largohen nga vendi i punës pa ndërruar rrobat, a i dinë rreziqet e mundshme shëndetësore të paraqitura nga trajtimi i pasigurt nga agjentët biologjikë.</i> <i>* Organizoni trajnime për punë të sigurt me agjentë biologjikë, përdorimin e PPM-ve, procesin e dezinfektimit etj. Mbani shënime në lidhje me trajnimet.</i>			
3.	Testoni nëse të punësuarit janë të vetëdijshëm për zinxhirin e infektimit dhe rrugët e mundshme të hyrjes dhe transmetimit të agjentëve biologjikë: frymëmarrja, gëlltitja, thithja përmes lëkurës. Rregullore (MPMS) Nr.05/2017, Neni 10 <i>* Testoni të gjithë të punësuarit në lidhje me zinxhirin e infektimit. Trajnoni sërish të punësuarit nëse njohuritë e tyre kanë mangësi të konsiderueshme.</i>			
4.	A ka ndonjë të punësuar veçanërisht të rrezikuar ndaj sëmundjeve biologjike: gratë shtatzëna, të punësuarit me alergji të veçanta ose astmë, sistem imunitar të dobët? Rregullore (MPMS) Nr.05/2016, Shtojca III, paragrafi 2 <i>* Pyetni të gjithë të punësuarit a i dinë të drejtat e tyre dhe masat e posaçme të sigurisë dhe shëndetit të tyre.</i> <i>* Pyesni të gjitha gratë e moshës riprodhuese, a kanë njohuri rreth rrezikut të ekspozimit që mund të prekë fëmijën e palindur (p.sh. klamidia, toksoplazma, rubeola dhe listeria)?</i> <i>* Trajnoni sërish të punësuarit nëse njohuritë e tyre kanë mangësi të konsiderueshme.</i>			
5.	A asgjësohet materiali i mbeturinave në përputhje me masat speciale? A asgjësohet materiali i mbeturinave në mënyrë të sigurt? A është lehtësisht i qasshëm material i mbeturinave? Rregullore (MPMS) Nr.05/2017, Nenet 7.2.8, 16.2.2 <i>* Testoni nëse të punësuarit kanë njohuri për procedurat (a i dinë) e menaxhimit të mbeturinave.</i>			

	* Sigurohuni që mbeturinat të mblidhen dhe asgjësohen në mënyrë të sigurt që të mos mund të qasen me lehtësi, dhe të parandalohet qasja e publikut. * Sigurohuni që të ofrohet grumbullimi dhe asgjësimi i mbeturinave speciale (p.sh. enë speciale për gjilpëra dhe objekte të mprehta).			
6.	A pastrohen rregullisht sipërfaqet e vendit të punës dhe a përdoren agjentë dezinfektues? Rregullore (MPMS) Nr.05/2017, Nenet 7.2.4, 9 * Kontrolloni nëse ekziston plani i pastrimit dhe a ruhen shënime për aktivitetet e pastrimit. Bëni një plan nëse nuk ka një të tillë dhe sigurohuni që plani të ndiqet.			
7.	A janë të disponueshme të gjitha pjesët e kërkuara të pajisjeve mbrojtëse personale, përfshirë përparëset sterile, dorezat e përshtatshme, kostumet e pastrimit, maskat kirurgjikale, kapelat dhe pelerinat? Të punësuarit nuk duhet të mbajnë pajisje mbrojtëse jashtë vendit të punës. Rregullore (MPMS) Nr.05/2017, Nenet 9.1.2, 9.2, 9.3, Shtojca VI * Sigurohuni që pajisjet mbrojtëse të ruhen aty ku nuk mund të kontaminohen nga substancat e rrezikshme biologjike dhe ku nuk do të kontaminojnë veshjet personale. * Sigurohuni që PPM-të nuk përdoren jashtë vendit të punës. * Kostot financiare të PPM-ve duhet të mbulohen nga punëdhënësi.			
8.	Të punësuarit duhet të informohen/trajnohen pse duhet t'i përdorin PPM-të. Rregullore (MPMS) Nr.05/2017, Neni 10.1.4 * Pyesni të gjithë të punësuarit se cilat PPM duhet t'i përdorin dhe pse (p.sh. kur dhe pse duhet të përdorin dorëza, ose maskë fytyre, çfarë dorezash do të përdorin, ku janë këto dorëza).			

9.	A ofrohen vende të ndara të ruajtjes për veshjet e punës ose mbrojtëse dhe për veshjet normale? Rregullore (MPMS) Nr.05/2017, Nenet 5, 7, Shtojca VI * <i>Ofroni ruajtje për pajisjet mbrojtëse ku nuk mund të kontaminohen nga substanca të rrezikshme biologjike dhe ku nuk do të kontaminohen veshjet personale.</i> * <i>Vizitoni dhomën e zhveshjes së punëtorëve</i>			
10.	Të punësuarve duhet t'u sigurohet një objekt dekontaminimi dhe pastrimi i përshtatshëm për punën që kryhet. Rregullore (MPMS) Nr.05/2017, Shtojca VI (agjentët biologjikë të grupeve 2, 3 dhe 4) * <i>Kontrolloni planin hapësinor. Pyesni të gjithë të punësuarit, ku ruhen pajisjet e punës.</i>			
11.	Të punësuarit duhet të bëjnë dush para se të largohen nga zona e kontrolluar. Rregullore (MPMS) Nr.05/2017, Shtojca VI (agjentët biologjikë të grupeve 3 dhe 4) * <i>Pyetni të gjithë të punësuarit që punojnë me agjentë biologjikë të grupeve 3 dhe 4, sa shpesh bëjnë dush?</i> * <i>Verifikoni nëse kjo kërkesë e higjienës dhe sigurisë është përfshirë në programin e trajnimit dhe informimit.</i>			

12.	Të punësuarit nuk duhet të pinë, hanë, pinë duhan dhe aplikojnë kozmetikë në vendet e tyre të punës. Rregullore (MPMS) Nr.05/2017, Neni 9.1.1 Vëzhgoni nëse: * të punësuarit pinë, hanë, pinë duhan ose aplikojnë kozmetikë në vendin e punës * ndonjë cigare, paketim cigaresh, shkrepëse paketim ushqimesh, ushqimi i papërfunduar ose gota janë të dukshme në vendin e punës, duke treguar që të punësuarit pinë dhe hanë dhe pinë duhan në vendin e punës * pirja e duhanit, ngrënia, pirja dhe aplikimi i kozmetikës në vendin e punës duhet të ndalohet për shkak të rrethanave të sigurisë						
13.	Shenjat e paralajmërimit dhe të sigurisë duhet të vendosen në zonën ku përdoren agjentët biologjikë. A janë lehtë të lexueshme? A janë shënjuar qartë zonat/detyrat e përcaktuara për përdorim të PPM-ve? Rregullore (MPMS) Nr.05/2017, Neni 7.2, Shtojca II Rregullore (MPMS) Nr.04/2016						
							
Duhet të përdoren pajisjet e frymëmarrjes		Duhet të përdoren dorezat e sigurisë		Duhet të vishen veshje mbrojtëse për tërë trupin			
							
Ndalohet pirja e duhanit		Ndalohet hyrja për persona të paautorizuar		Rrezik biologjik			

14.	A e njohin të punësuarit simbolin e bio-rrezikut? Rregullore (MPMS) Nr.05/2017, Neni 10			
15.	A janë shënuar dhe a janë të disponueshme objektet e ndihmës së parë? Rregullore (MPMS) Nr.05/2017, Neni 9 * <i>Kontrolloni nëse mund t'i shihni shenjat e sigurisë për objektet e ndihmës së parë nga disa pika të lokacionit. Nëse nuk mund t'i shihni shenjat, pyesni punëtorët nëse e dinë ku ndodhen objektet e ndihmës së parë. Vendosni ose rivendosni shenjat.</i> * <i>Kontrolloni nëse larja e syve dhe dushet janë në gjendje pune dhe lehtësisht të arritshme kur kërkohet.</i>			
	 Dushi i sigurisë  Pastrues për sy			
INSPEKTIMI I DOKUMENTEVE NË ZYRË				
	* <i>Takohuni me përfaqësuesit e menaxhmentit (nëse është e mundur) dhe/ose ekspertët për SSHP.</i> * <i>Shpjegoni vëzhgimet tuaja të mira dhe jo të mira nga vizita juaj në lokacion.</i> * <i>Në rastet e mangësive të vëzhguara, sqaroni situatën (psh. të punësuarit nuk përdorin PPM, hanë në vendet e punës etj.), gjeni shkakun dhe bëni plane për përmirësime.</i> * <i>Tregohuni miqësorë, sqaroni dhe këshillojini për detyrimet e tyre në lidhje me trajtimin e sigurt të kimikateve, jepni shembuj të mirë nëse është e mundur.</i>			
16.	A jeni ju si punëdhënës në pajtueshmëri me afatin ligjor për njoftimin e autoriteteve kompetente në lidhje me veprimet e ndërmarra për herë të parë me agjentët biologjikë të grupeve 2, 3 dhe 4? Rregullore (MPMS) Nr.05/2017, Neni 14.1			

	<i>* Njoftimi duhet të bëhet të paktën 60 ditë para fillimit të punës.</i>			
17.	A ekziston një plan emergjent për mbrojtjen e punëtorëve nga ekspozimi ndaj agentëve biologjikë të grupit 3 ose 4 që mund të vijnë nga humbja e kontrollit fizik? Rregullore (MPMS) Nr.05/2017, Neni 8.1 <i>* Testoni nëse të punësuarit janë informuar dhe trajnuar se çfarë të bëjnë në rast emergjence ose problemesh. Planifikoni rikualifikimin nëse njohuritë e tyre kanë mangësi të konsiderueshme.</i>			
18.	A dihet numri dhe lista e të punësuarve të ekspozuar ndaj agentëve biologjikë? Rregullore (MPMS) Nr.05/2017, Nenet 8.1, 12 <i>* Gjeni numrin e të punësuarve të ekspozuar.</i> <i>* Në rast se të punësuarit punojnë me agentë biologjikë të grupit 3 dhe/ose 4, kompania mban një listë të të punësuarve të ekspozuar. Lista duhet të mbahet të paktën 10 vjet pas përfundimit të ekspozimit, në përputhje me ligjet kombëtare dhe/ose praktikën.</i> <i>* Në rastin e atyre ekspozimeve, të cilat mund të çojnë në infeksione, lista duhet të mbahet për një kohë të duhur deri në 40 vjet pas ekspozimit të fundit të njohur.</i>			
19.	Mbani dokumentacionin në lidhje me trajnimet mbi masat paraprake universale, pajisjet/veshmbathjet personale mbrojtëse etj. Sigurohuni që shënimet e trajnimit të përfshijnë efektet shëndetësore, kontrollet, metodat e punës së sigurt etj. Rregullore (MPMS) Nr.05/2017, Neni 10 <i>Sigurohuni që të punësuarit janë trajnuar në mënyrë efektive dhe udhëzimet e sigurisë përfshijnë:</i> <i>• rreziqet e mundshme për shëndetin</i> <i>• masat për të parandaluar ekspozimin</i> <i>• kërkesat ndaj higjienës</i> <i>• përdorimi i pajisjeve dhe veshjeve mbrojtëse</i>			

	• <i>hapat që duhen ndërmarrë nga të punësuarit, përfshirë veprimet e shpëtimit, për të parandaluar incidentet dhe në rast incidentesh</i>			
20.	A janë marrë masa për të zvogëluar dhe parandaluar rreziqet biologjike? Rregullore (MPMS) Nr.05/2017, Nenet 5, 7 <i>Kontrolloni dokumentin e vlerësimit të riskut për të identifikuar nëse janë vlerësuar masa të tjera parandaluese, diskutoni me ekspertin për SSHP.</i> <i>Verifikoni:</i> * <i>a ekzistojnë procedura për situata të mundshme emergjente?</i> * <i>a ka pajisje emergjente që mund të kërkohen në vendin e punës ?</i> * <i>a ka shenja të duhura sigurie në vendet e punës nëse është e nevojshme?</i> * <i>a ka ventilim shkarkues nëse është i nevojshëm (a mirëmbahet rregullisht?)?</i> * <i>a kryhet pastrimi/dezinfektimi i rregullt i dyshemesë, mureve dhe sipërfaqeve të tjera?</i>			
21.	Sigurohuni që të punësuarit dërgohen në kontrole të detyrueshme shëndetësore në intervale të rregullta. Rregullore (MPMS) Nr.05/2017, Neni 15 <i>Kontrolli fillestar mjekësor i të punësuarve duhet të bëhet menjëherë pas punësimit. Kontrolli tjetër shëndetësor duhet të bëhet duke marrë parasysh rreziqet e agjentëve biologjikë. Gjithmonë mbani shënime të kontrolleve.</i>			
22.	A e ka përfshirë mbikëqyrja mjekësore vaksinimin e të punësuarve potencialisht të ekspozuar? Shënime duhet të përmbajnë të dhëna në lidhje me imunizimin dhe testimin e të punësuarve siç kërkohet nga natyra e rrezeqeve biologjike (p.sh. vlerësimi i HBV, testimi i antitropave). Rregullore (MPMS) Nr.05/2017, Neni 15.3 <i>Ofroni vaksinim dhe teste nëse është e nevojshme, mbani shënime.</i>			
PAS VETËVLERËSIMIT				

	* Diskutoni me menaxhmentin e lartë për vëzhgimet dhe konkluzionet tuaja për përmirësimet e nevojshme. * Diskutoni me menaxherat e nivelit të mesëm të lokacionit/vendit të punës së vizituar për vëzhgimet dhe konkluzionet tuaja për përmirësimet e nevojshme. * Në rast se keni një ofrues të jashtëm të shërbimit të SSHP-së ose ekspert të SSHP-së, diskutoni me të për vëzhgimet dhe konkluzionet tuaja për përmirësimet e nevojshme. * Zbatoni masat e nevojshme të kontrollit të identifikuara gjatë vetëvlerësimit.			
--	---	--	--	--